




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 24.04.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.02.2020, pas shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019, sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-860/6, të datës 16.10.2019.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 25.02.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.02.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 69, të datës 21.01.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2019

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2019, në shumën prej 370,549.56€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet e programeve, nënprogrameve dhe projekteve si në vijim:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej 50,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi i Infrastrukturës Publike 18162;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej 100,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime -13, programi Administrata e Shëndetësisë 73011;
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej 50,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi i Administrata e Arsimit 92010;
 - 1.4 Mjetet financiare në shumë prej 30,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi i Administrata e Shëndetësisë 73011;
 - 1.5 Mjetet financiare në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi Administrata e Arsimit 92010;
 - 1.6 Mjetet financiare në shumë prej 20,549.56€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, Kulturë, Rini dhe Sport 85002;
 - 1.7 Mjetet financiare në shumë prej 100,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për investime kapitale - 30, programi i Infrastrukturës Publike 18162 në kodin e projektit 44698 raste emërgjente.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, të këtij vendimi lejohen për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e faturave për shërbime publike të rrymës, ujit, mbeturinave, pagesën e faturave për furnizime me material

për zyre, medikamente për shëndetësi dhe derivate të naftës, mbulimin e shpenzimeve për ndihmë qytetarëve për shërim dhe terapi shëndetësore, ndihmë studentëve për studime, ndihmë klubeve sportive, ndihmë për shpenzime të ceremonisë së varrimit dhe projekteve të Organizatave Jo Qeveritare dhe nënparagrafi 1.7, lejohet për realizimin e investimeve në projekte kapitale, që ndërlidhen me rastet emërgjente në shërbim të përmirësimit të kushteve të jetesës për qytetarët e komunës.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 25.02.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.02.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 108, të datës 28.01.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2018 dhe 2019, në vitin fiskal 2020

1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2018 dhe 2019, në vitin fiskal 2020 në shumë të përgjithshme prej 2,549,524.31€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 108, të datës 21.01.2020.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 52,000.00€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 249,900.63€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike shpenzime për komunal shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 42,652.46€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 134,854.42€;
 - 2.5 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 2,070,116.80€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit është e detajizuar dhe e përshkruar, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB,
Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

